



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2017

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Ekonomi e thelluar

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigjja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

- **Pyetjet me zgjedhje**

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë Varianti A	B	D	B	C	B	D	B	C	A	C
Përgjigja e saktë Varianti B	D	B	C	A	C	B	D	B	C	B

- **Pyetjet me zhvillim**

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë te tjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin

Pyetja 11

3 pikë

- në ekonominë e tregut mbizotëron pronësia private ; në ekonominë e komanduar mbizotëron prona shtetërore.
- ekonomia e tregut i merr vendimet në mënyrë individuale, nga bashkëveprimi i individëve në treg/bashkëveprimi i kërkesës me ofertën, ndërsa në ekonominë e komanduar, i merr në mënyrë të centralizuar/i merr shteti(qeveria)
- çmimet janë të liberalizuara/ përcaktohen nga tregu, ndërsa në ekonominë e komanduar përcaktohen nga qeveria/ në mënyrë të centralizuar, etj.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan saktë të tre krahasimet

OSE

2 pikë Nëse shkruan saktë dy nga krahasimet


1 pikë Nëse shkruan saktë një krahasim

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 12

3 pikë

- a) nuk ndryshon
- b) bie
- c)



Pyetja 13

3 pikë


- a) 2

përqindja e ndryshimit të sasisë së kërkuar: $\Delta Q = \frac{550-450}{\frac{550+450}{2}} \times 100 = 20\%$

përqindja e ndryshimit të çmimit: $\Delta P = \frac{|190-210|}{\frac{190+210}{2}} \times 100 = \frac{20 \times 100}{200} = 10\%$

$$E_p^D = \frac{20\%}{10\%} = 2$$

- b) elastike
- c)



Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse llogarit saktë elasticitetin duke treguar veprimet, gjen si është kërkesa dhe ndërton saktë grafikun.

OSE

2 pikë Nëse llogarit saktë elasticitetin duke treguar veprimet dhe gjen si është kërkesa.

2 pikë Nëse llogarit saktë elasticitetin duke treguar veprimet dhe ndërton saktë grafikun.

2 pikë Nëse gjen si është kërkesa dhe ndërton saktë grafikun.


1 pikë Nëse llogarit saktë elasticitetin duke treguar veprimet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Shënim:

- Nxënësi e merr pikën e kërkesës a) nëse paraqet veprimet e kryera.
- Nxënësi nuk merr pikë nëse gjen si është kërkesa, pa llogaritur koeficientin e elasticitetit të kësaj kërkesë.(a)
- Nxënësi nuk merr pikë me ndërtimin e grafikut, pa iu përgjigjur pikës a) dhe b).

Pyetja 14 **3 pikë**



Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shënon saktë P, ATC dhe Q, duke arsyetuar për mënyrën si i gjen;

OSE

2 pikë Nëse shënon saktë P dhe ATC, duke arsyetuar për mënyrën si i gjen;

2 pikë Nëse shënon saktë P dhe Q, duke arsyetuar për mënyrën si i gjen;

1 pikë Nëse shënon saktë P, duke arsyetuar për mënyrën si i gjen;

1 pikë Nëse shënon saktë Q, duke arsyetuar për mënyrën si i gjen;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15

3 pikë

a) 6000

b) 80

c) 150

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse llogarit saktë të tria kostot;

OSE

2 pikë Nëse llogarit saktë dy kosto;

1 pikë Nëse llogarit saktë një kosto;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16

3 pikë

a) janë letra me vlerë/pret të marrësh të ardhura

b)

- aksioni të bën bashkëpronar, obligacioni të bën kreditor;
- nga aksioni merr dividend, nga obligacioni merr normë interesi fikse;
- obligacioni ka kohë maturimi, aksioni nuk ka;
- aksioni e bën të transferueshme pronën, obligacioni nuk e bën.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan një tipar të përbashkët dhe dy dallime;

2 pikë Nëse shkruan një tipar të përbashkët dhe një dallim;

1 pikë Nëse shkruan një tipar të përbashkët;

1 pikë Nëse shkruan një dallim;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **3 pikë**

- a) 4
- b) 2
- c) friksionale

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse shkruan saktë të tria kërkesat;
OSE
- 2 pikë** Nëse shkruan saktë dy nga kërkesat;
- 1 pikë** Nëse shkruan saktë një kërkesë;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **3 pikë**

- a) nuk ndryshon
- b) nuk ndryshon
- c) rritet

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse shkruan saktë të tria kërkesat;
OSE
- 2 pikë** Nëse shkruan saktë dy nga kërkesat;
- 1 pikë** Nëse shkruan saktë një kërkesë;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 **3 pikë**

- të ardhurat për frymë /norma e varfërisë/rritja ekonomike
- GNI (dinamika e ndryshimeve të të ardhurave kombëtare bruto)
- HDI (indeksi i zhvillimit njerëzor) /treguesit e jetëgjatësisë/koeficienti i lindshmërisë (vdekshmërisë/vdekshmërisë foshnjore)
- niveli i arsimit, etj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse shkruan saktë tre tregues;
OSE
- 2 pikë** Nëse shkruan saktë dy tregues;
- 1 pikë** Nëse shkruan saktë një tregues;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **3 pikë**

- raporti eksport-import i një vendi;
- normat e interesit bankar/kredi/depozita;
- prirjet/parashikimet për kursin e këmbimit në të ardhmen;
- inflacion;
- dërgesat e emigrantëve, etj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse shkruan saktë të tre faktorët;
OSE
- 2 pikë** Nëse shkruan saktë dy nga faktorët;
- 1 pikë** Nëse shkruan saktë një faktor;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.